REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 24/17
Datë/Datum. 23.01.2017
PRISHTINË - PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEKO 16-022-111**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Gëlqere të hidratizuar**
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"TTC" SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Enver Maloku, Bll. 7, Hy 5/13
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 203 370 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Shehadin Bajrami
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shehadin.bajrami@ttc-ks.com
(Adresa elektronike)

23-01-2017 — SH.P.K. »TTC« PRISHTINË
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë është publikuar 25-01-2016.

Afati për dorëzimin e tenderit 07-03-2016, ora 13:00, vendi Kastriot (Obiliq) TCB.

Kriteri për dhënje të kontratës – Çmimi më i ulët.

Letër standarde për tenderuesin e eleminuar dt. 21-04-2016 (pranuar përmes emailit me datë 22-04-2016)

Kerkesa për rishqyrtimi e vendimit (dërguar me datë 27-04-2016)

Vendimi për refuzimin e kërkesës datë 29-04-2016 (pranuar përmes emailit)

Njoftimi për dhënie të kontratës, date 06-05-2016

Ankesa në OSHP nr. 129/16, datë 10-05-2016

Ekspertiza e ekspertit nr. 129/16 dhe 135/16, datës 01-06-2016,

Vendimi nga OSHP me anë të cilit aprovohet ankesa jonë dhe kthehet lënda në rishqyrtim, datë 24-06-2016

Vendim përfundimtar nga Prodhuesi "US Construction" Maqedoni 03-07/315, datë 30-06-2016 me të cilin caktohet kompania jonë (TTC SHPK) e vetmja përfaqësuese e denjë në këtë tender dhe i tërheq të gjithë autorizimet tjera që i ka dhënë,

Leter standarde për sqarim nga Autoriteti, e datës 06-07-2016,

Pergjigje nga ana jonë në kërkesën për sqarime shtesë përmes emailit të datës 07-07-2016,

Leter standarde per sqarim drejtuar Prodhuesit US CONSTRUCTION nga Autoriteti dt. 12-07-2016

Pergjigje e prodhuesit US CONSTRUCTION permes emailit, dt. 14-07-2016,

Pyetje nga Autoriteti per prodhuesin US CONSTRUCTION, datë 18-07-2016,

Pergjigje e Prodhuesit tek Autoriteti, datë 19-07-2016

Leter standarde per sqarim nga Autoriteti e dates 28-07-2016,

Pergjigje nga operatori TTC lidhur me sqarimet e Autoritetit, datë 04-08-2016,

Leter standarde per sqarim nga Autoriteti e datës 09-08-2016,

Pëgjigje nga Operatori TTC lidhur me sqarimet e kërkuara nga Autoriteti, datë 12-08-2016,

Leter standarde për tenderuesin e eliminuar, datë 18-08-2016 (25-08-2016)

Kërkesa për rishqyrtim e vendimit nga TTC, datë 30-08-2016

Vendimi (Njoftimi) nga Autoriteti Kontraktues per dhënje të kontratës 29-08-2016 (30-08-2016)

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga AK, datë 01-09-2016

Shikimi i dosjes fizike të tenderuesit të suksesshëm (përgjegjshëm) nga ana jonë, datë 02-09-2016

Kërkesë për rishqyrtim të vendimit / njoftim për dhënje të kontratës të datës 30-08-2016, parashtruar me datë 05-09-2016 pas gjetjeve të shkeljeve që kemi hasur në dosjen e fituesit.

Kerkesë për AK përmes emailit për qasje në shikim të të gjithë dosjeve të tenderuesve, datë 07-09-2016

Refuzimi i kërkesës për qasje në dokumentet e tenderuesve, dt. 08-09-2016 (përmes emailit)

Vendimi nga AK nr. 1867/08-09-16 me të cilin aprovohet pjesërisht kërkesa jonë e datës 05-09-2016

Vendimi nga AK i datës 09-09-2016 për anulimin e dhënjes së kontratës

Ankesa jonë në OSHP – dt. 13-09-2016 për shkak të anulimit nga tenderi,

Urdhëresa e OSHP-së nr. 309/16 ndaj KEK me të cilën aprovohet ankesa jonë në tërësi,

Njoftimi për dhënje të kontratës kompanisë sonë TTC nga KEK datë 01-11-2016,

Ankesa në OSHP e operatorit NTSH DIARI nr. 404/16

Vendimi nga OSHP për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 404/16 dt. 30-12-2016

Njoftimi nga KEK me të cilin anulohet aktiviteti i prokurimit dhe anulohet dhënja e kontratës kompanisë sonë TTC SHPK datë 06-01-2017

Kerkesa ne AK KEK per rishqyrtim te vendimit per anulimin e aktivitetit te prokurimit

Refuzimi nga KEK per rishqyrtimin e lendes (permes emailit te dates 12-01-2017)

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	X				**Jo**	

Procesi ka qenë transparent dhe i rregullt. Kanë marr pjesë 15 ofertues.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				Jo	

-Jemi njoftuar me date 25-08-2016 për eliminimin nga tenderi.
-Kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit me date 30-08-2016.
-Autoriteti e ka refuzu kërkesën tone duke mos e arsyetu fare atë kërkesë dhe provat shtesë nuk i ka marr parasysh, datë 01-09-2016
-Autoriteti brenda afatit ligjor për ankesa (nuk e respekton afatin e ankesave), e shpall Njoftimin per Dhënje të Kontratës, datë 29-08-2016 (30-08-2016).
-Me datë 02-09-2016, na lejohet qasje në dokumentet e operatorit fitues NTSH DIARI
-Me datë 05-09-2016 parashtrojmë Kërkesë për Rishqyrtim te Vendimit të datës 30-08-16, pas shkeljeve ligjore që i kemi hasur në dosjen e fituesit.
- Me datë 07-09-16 Paraqesim kërkesë për shikim të dosjeve tjera,
- Me datë 08-09-2016 na refuzohet kërkesa për shikim të dosjeve të tenderuesve,
- Me datë 08-09-2016 AK merr vendim nr. 1867, që të aprovoj pjesërisht kërkesën tonë për rishqyrtim të datës 05-09-2016.
- Me datë 09-09-2016 AK merr vendim për Anulim të Dhënjes së Kontratës
- Ne paraqesim ankese ne OSHP kunder vendimit te AK KEK per anulimin tonë,
- OSHP leshon urdheresen nr. 309/16 për AK KEK me të cilën e detyron që të na pranoj kompaninë tonë TTC SHPK të përgjegjshme,
- AK KEK shpall kompaninë TTC të përgjegjshme dhe fituese e tenderit,
- Operatori i paknaqur NTSH DIARI parashtron ankesë në OSHP,
- OSHP nxjerr vendim nr. 404/16 për anulimin e aktivitetit të prokurimit
- AK KEK nxjerr Njoftimin për anuliimin e aktivitetit të prokurimit dhe Njoftim për anulimin e dhënjes së kontratës,
- Ne paraqesim kërkesë në AK KEK në bazë të këshillës ligjore në njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit,
- AK KEK nuk na merr parasysh kërkesën tonë për rishqyrtim.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkeljet vijuese të ligjeve pozitive në Kosovë, në vijim po i përmendim disa por kërkojmë nga eksperti dhe Organi Shqyrtues që mos të kufizohet vetëm në këto dipozita:

Neni 1 – Qëllimi më efikas I përdorimit të fondeve publike, jodiskriminimi dhe transparenca nga zyrtarët e Prokurimit,

Neni 6 – Parimi i Ekonomicitetit të procedurës

Neni 7 – Barazimi dhe jodiskriminimi si dhe transparenca

Neni 10 – Mjetet për promovimin e transparencës

Neni 55 – Menyra e komunikimit,

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 64 – Deshmite e kerkesave,

Neni 66 – Përshtatshmëria Profesionale,

Neni 67 – Provat Shkresore,

Neni 69 – Aftësia teknike dhe profesionale e tenderuesit,

Neni 70 – Standardet për sigurimin e cilësisë,

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Neni 104 – Parimet e themelore

Vendimi i OSHP-së nr. 129/16, datë 24-06-2016, me të cilin aprovohet ankesa jonë dhe me të cilën konfirmohet që dokumentacioni ka qenë në harmoni me dosjen.

Urdhëresa e OSHP-së nr. 309/16 dt. 21-10-2016

Ligji I Procedures Administrative 02/L-28, Neni 4 – Parimi I balancimit të interesave publike dhe private,

Ligji I Procedures Administrative 02/L-28, Neni 6 – Parimi I Proporcionalitetit,

Ligji I Procedures Administrative 02/L-28, Neni 7 – Parimi I objektivitetit dhe paanshmërisë,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues (Korporata Energjetike e Kosovës), ka vepruar në kundërtshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në kundërshtim me Parimet e Ligjit të Procedurës Administrative nr. 02/L-28, Vendimin e OSHP-së nr. 129/16 datë 24-06-2016, si dhe akteve tjera nënligjore që janë në fuqi, në

këtë mënyrë duke:

- **Anuluar aktivitetin e prokurimit KEKO 16-022-111 dhe**

- **Duke vepruar në kundërshtim me 2 vendimet dhe 3 ekpertizat e mëhershme të OSHP-së.**

Autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, me anë të vendimeve arbitrare (njoftimit për anulimin e kativitetit të prokurimit dhe njoftimin për anulimin e dhënjes së kontratës) ka zbatuar vendimin e OSHP-së nr. 404/16 me të cilin vendim anulohet pa bazë ligjore aktiviteti i prokurimit KEKO-16-022-111.

Edhe pse në Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit vendoset "këshilla ligjore" që pala e paknaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë në bazë të nenit 108/A të LPP-së dhe këtë të drejtë e shfrytëzojm ne si palë e dëmtuar, mirëpo AK KEK nuk dëshiron që ta pranojë ankesën / kërkesën tonë dhe na shkruan një email me të cilin na njofton që nuk do ta shqyrtojnë ankesën / kërkesën pasi që kemi një vendim të OSHP-së 404/16...

Andaj ne e shfrytëzojmë bazën ligjore për të parashtruar ankesë dhe paraqesim si vijon...

Pala ankuese NTSH DIARI në procesin 404/16 ka manipuluar me informata që ka paraqitur ndaj panelit shqyrtues të OSHP-së. Kështu duke vënë në lajthitje anëtarët e panelit dhe duke iu prezentuar të dhëna komplet ndryshe nga gjendja faktike....

Në bazë të vendimit nr. 404/16 i shpallur në webfaqe të OSHP-së me datë 30-12-2016, Organi Shqyrtues i Prokurimit merr vendim që të ANULOJ aktivitetin e prokurimit KEKO-16-022-111, si dhe të aprovoj ankesën e ankuesit NTSH DIARI e cila në përmbajtje ka pasur informata jo të sakta dhe ka paraqitur prova lajthitëse për panelin shqyrtues!

Pala ankimore NTSH DIARI, që nga fillimi i procedurës së tenderimit ka manipuluar me informata dhe dokumentacion fillimisht tek zyrtarët e KEK-ut, ngase në tender fillimisht kanë marr pjesë 15 ofertues, mirëpo ofertuesi REDONI HM (me cmim më të lirë në ofertë, por i papërgjegjshëm) dhe ofertuesi NTSH DIARI (ndër më të shtrenjtit në ofertë) për qudi qëllojnë të të njëjtës familje! Dhe për qudi shfrytëzojnë të njëjtën taktikë të eliminimit të konkurrencës, kështu duke i manipuluar zyrtarët jopërgjegjës në kompanitë prodhuese JELEN DO - Serbi dhe US CONSTRUCTION - Maqedoni të cilët i bindin që të shkruajnë email për tërheqje të autorizimeve të dhëna për kompanitë tjera, emailin e dërgojnë tek zyrtari i KEK-ut i cili nuk ka qenë në komision të vlerësimit dhe për çudi zyrtarët e KEK-ut aprovojnë emailat dhe vendosin që në garë për këtë tender të jenë vetëm 2 kompani (REDONI HM dhe NTSH DIARI, të njëjtës familje) nga e cila REDONI HM e posedon certifikatën ISO 9001:2008 të manipuluar (pa datë) dhe e ka cmimin më të lirë sesa cmimi kushtues i mallit. Kurse NTSH DIARI (i cili nuk i ka pasur dokumentacionin në rregull teknikisht – shih vendimin e fundit të KEK-ut) shpallet fitues i kontratës KEKO-16-022-111 me një cmim të përafërt rreth **200,000.00 EURO** më të shtrenjtë sesa kompania jonë TTC SHPK. Me këtë vendim anulues për habi pajtohen 13 kompani që kanë qenë në garë !!!

Kompania jonë TTC SHPK e paknaqur me këtë paraqet ankesë në OSHP (shih vendimin 129/16 dhe 135/16 me të cilin pranohet dokumentacioni jonë i përgjegjshëm) dhe lënda kthehet në rishqyrtim.

Për çudi prapë zyrtarët e KEK-ut vendosin që kontratën te ia japin kompanisë NTSH DIARI e cila ishte e papërgjegjshme (pasi kemi kërkuar ne (TTC) shikimin e dokumentacionit të NTSH DIARI e kemi vrejtur që nga 5 kërkesat teknike, i njëjti nuk i plotësonte 3 prej tyre). Mirëpo para se me shpall fituesin, zyrtarët e KEK-ut fillilmisht

na shpalllin neve TTC SHPK si kompani jo të përgjegjëshme edhe pse kishin vendimin e OSHP-së 129/16.

Pas kërkesës sonë për rishqyrtim të dokumentacionit, më në fund zyrtarët e KEK e marrin vesh që kompania NTSH DIARI nuk është e përgjegjshme teknikisht / mungesë dokumentacioni (kjo bëhet nga komisioni i 3-të i KEK-ut, sepse 2 komisionet e para "nuk e kanë vrejtur" që nuk i ka dokumentet në dosje).

Kompania TTC SHPK prapë e paraqet ankesën në OSHP dhe pasi mbahet seanca, merret vesh që pretendimet e KEK-ut që prodhuesi US CONSTRUCTION nuk posedon certifikatë ISO 9001:2008 nuk qëndrojnë dhe se nuk kanë mundur që ti vërtetojnë pretendimin e tyre me prova.

OSHP nxjerr vendim (URDHËRESË) nr. 309/16 me të cilin urdhërohet KEK-u që të pranoj dokumentacionin tonë (TTC) si të përgjegjshëm dhe të vazhdoj me procurën nën kërcnimin e marrjes së licencës së prokurimit zyrtarëve që nuk i binden ligjit.

Zyrtarët e KEK pasi që mbesin me të vetmen kompani të përgjegjshme TTC SHPK dhe bazuar në URDHËRESËN e OSHP-së, atëherë e shpallin fitues të tenderit kompaninë tonë TTC.

E paknaqur me vendimin kompania e cila ishte e papërgjegjshme dhe për **200,000.00 EURO më e shtrenjt** në ofertë NTSH DIARI paraqet ankesë në OSHP dhe ashtu sic kishte vepruar me zyrtarët e KEK më herët, prapë të njëjtën taktik e përdorë edhe në seancën e mbajtur, ku paraqet informata jo të sakta dhe manipuluese në seancë, meqë rast i qet në lajthitje edhe antarët e panelit të OSHP-së.

E njëjta kompani nuk paraqet ankesë në rastin kur shpallet e papërgjegjshme nga AK KEK, por ankesën e e paraqet vetëm në momentin kur shpallet fitues kompania TTC SHPK afërisht pas 1 muaji. Dhe duke luajtur rolin e "hetuesit" shkon në Maqedoni dhe nxjerr informata për një kompani që nuk ekziston dhe ia paraqet panlit të OSHP-së këto informata.

Eksperti shqyrtues i cili ishte në rrjedha të kësaj lënde, e njihte fort mirë procesin dhe jep rekomandime që të anulohet ankesa e NTSH DIARI ngase ishte pabazë ligjore.

SQARIM:

Kompania që e ka lëshuar ISO CERTIFIKATËN 9001:2008 quhet ("Actep IKS" Dooel) apo në gjuhën maqedone ("ACTEP **ИКС**" Dooel) dhe NUK QUHET sic e ka paraqitur ankuesi me emrin (ASTER MKS) këtu ka qenë lajthitja sepse shkronjat (ИКС) në gjuhën maqedone janë (IKS) dhe kurrsesi jo (MKS). – SHIH BASHKANGJITUR CERTIFIKATËN ISO 9001:2008 dhe shiko vulën.

Kjo vërtetohet edhe nga vula e kompanisë por edhe nga dokumenti i Qendra e Biznesit në Maqedoni nr. 0805-50/151020160004067, datë 04-07-2016 (e noterizuar) në të cilën janë të cekura të dhënat e biznesit. (SHIH BASHKANGJITUR DOKUMENTIN)

Sa i përket veprimtarisë së biznesit, po ua marr një shembull konkret:

Kompania jonë TTC SHPK, në Agjensionin për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë veprimtari primare e ka (4613 –

Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndës së drurit dhe materialeve të ndërtimit) – Aktivitet Primar. Mirëpo i ka edhe 55 aktivitete tjera me të cilat mund të merret duke mos u kufizuar vetëm në ato. Andaj në shikim të parë mund të konstatohet që kjo kompani merret kryesisht me shitjen e lëndës së drurit, mirëpo kjo nuk qëndron e saktë sepse asnjëherë nuk jemi marr me dru, pasi që kjo është vetëm proces procedural i regjistrimit të biznesit. (SHIH BASHKANGJITUR DOKUMENTIN NGA ARBK – KOSOVE)

Andaj edhe me veprimtarinë e kompanisë "ASTEP IKS" ka manipuluar ankuesi dhe ju ka paraqitur të dhëna jo të sakta.

Vlenë të theksohet që kompania prodhuese **maqedone / amerikane US CONSTRUCTION** nuk ka llogari që të bëjë mashtrime të tilla pasi që pronari i saj është maqedono-amerikan dhe për më tepër kompania posedon tashmë edhe certifikatën ISO 9001:2008 nga kompania gjermane TUV NORD e cila nuk është marr përbazë asnjëherë nga AK KEK! (SHIH BASHKANGJITUR CERTIFIKATËN GJERMANE ISO 9001:2008).

Gjithashtu vlenë të theksohet që Termoelektrona e Maqedonisë furnizohet që disa vite nga ky prodhues me gëlqere të njëjtë.

Andaj si përfundim, ju lusim që ti shqyrtoni edhe njëherë këto dokumente dhe të kuptoni që pala ankimore NTSH DIARI nuk është kompani serioze në tregun tonë dhe ka manipuluar me procedurën tenderuese që nga fillimi i saj... mjafton të shikoni kronologjinë e kësaj procedure.

Gjithashtu AK KEK e ka "shumë për zemër" këtë kompani NTSH DIARI, ngase ka vazhduar që ti jep tenderë me vlera MINIMALE për furnizim me gëlqere duke mos i shpallur asnjëherë në KRPP, mirëpo i shpall vetëm disa nga Njoftim për Nënshkrimin e Kontratës pas disa muajve...! kjo nënkupton që dikush po e ndihmon këtë kompani me gjithqka të mundshme për ta marr këtë tender dhe kjo nuk quhet ndryshe përveq se DISKRIMINIM dhe jo vetëm...!

Shih njoftimet: KEKO-17-164-147, KEKO-16-162-147, KEKO-16-163-147 gjithashtu ka edhe disa tjerë por ende sjan publikuar!

Kompania jonë TTC SHPK cdoherë ka paraqitur dokumentacionin e noterizuar dhe nga autoritetet kompetente dhe nuk ka qëllim tjetër përveq që ky proces të përfundoj sipas dispozitave ligjore në fuqi, ngase OSHP ka marr vendim për anulim të aktivitetit të prokurimit edhe pse nuk ka pasur asnjë vendim gjyqësor lidhur me dokumentacionin tonë i cili është shpallur i pavlefshëm. Sipas rregullores së OSHP-së dhe Ligjit të Prokurimit Publik, OSHP ka drejtë që të anuloj aktivitetin e prokurimit vetëm në rastet kur ka pasur shkelje nga Autoriteti Kontraktues....! Në këtë rast kemi pasur 2 vendime të OSHP-së dhe 3 ekspertiza të ekspertëve të OSHP-së që kompania jonë është e përgjegjshme.

Ju lusim që të keni parasysh që kompaninë tonë po e dëmtoni jomaterialisht dhe materialisht në një masë shumë të madhe dhe po na shkatrroni të ardhmen e biznesit tonë. Dhe e gjithë kjo po ndodh për shkak të manipulimeve nga persona të caktuar.

Kërkojmë që të anulohet / korrigjohet vendimi 404/16 i datës 30-12-2016 i cili është marr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe nën ndikimin e lajthimit me informata nga pala ankuese e cila nuk a ka mbrojtë vetveten dhe nuk ka sjell dokumentacion për ta dëshmuar që është e përgjegjshme ajo, mirëpo është marr me manipulime të informatave për kompaninë tonë dhe më shumë është marr me neve sesa me vetveten...!

Andaj bazuar në këto që u cekën, Ligjin e Prokurimit, Rregulloret dhe Direktivat Evropiane të Prokurimit , Ligjin e Procedurës Administrative, aktet nënligjore, referencat (kontratat) që kemi pasur me KEK për të njëjtin produkt i cili është pranuar si dhe të gjithë certifikatat janë pranuar, gjetjet e fundit në mangësitë e dosjeve të fituesve të tenderëve, kërkojmë nga ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT që që pas administrimit të provave, të veproj sipas nenit 105 të ligjit si dhe dispozitave tjera në fuqi që:

- Ankesën tonë ta aprovoj në tërësi si të bazuar në prova dhe ligjet pozitive,
- Ta anuloj vendimin e OSHP-së 404/16 dt. 30-12-2016
- Të mbetet në fuqi urdhëresa 309/16 e OSHP-së.
- Të marr masa ndaj operatorit ankues që ka paraqitur informata të pasakta.

Andaj ju lusim që ta shqyrtoni cdo pretendim tonin në këtë ankesë, bazën ligjore që është cekur më lartë, provat që janë të bashkangjitura në ankesë dhe të merrni vendim ligjor.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Ne si operator ekonomik, jemi dëmtuar në mënyrë materiale dhe jomateriale.

Dëmet materiale janë fitimi i humbur në këtë kontratë, i cili do të caktohet nga eksperti financiar.

Si dëm jomaterial për shkak të humbjes si punë referente për tenderat e ardhshëm si dhe reputacionin, kërkojmë shumën 300,000.00 Euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"(25-01-2016)*
- *Venimi i OSHP-së për aprovimin e ankesës, nr. 129/16, 135/16, datë 24-06-2016 (me të cilin thuhet që certifikata që kontestohet është në harmoni me dosjen e tenderit)*
- *Konkluzioni i OSHP-së, nr. 129/16, 135/16, datë 28-06-2016,*
- *Raportin nga Qendra e Regjistrimit të Bizneseve në Maqedoni nr. 0805-50/151020160004067, datë 04-07-2016 (e noterizuar), për të dhënat komplete të kompanisë që e ka lëshuar certifikatën ISO (kompania* "ACTER ИКС" Dooel) si dhe konfirmimin që kjo kompani ka funksionuar nga data 15-06-2002 deri me 03-03-2016 dhe pastaj e ka mbyll veprimtarinë në Maqedoni.
- *Certifikata ISO 9001:2008 e datës 20-06-2015e noterizuar (e cila është në dosje të tenderit),*

- *Certifikatën ISO 9001:2008 e datës 18-04-2016 (e lëshuar nga kompania gjermane* TÜV NORD CERT GmbH me seli në Zagreb – Kroaci)
- *Certifikata e konofrmitetit te kontrollit te produkteve te prodhuara EN 459-1:2010 (e noterizuar)*
- *Kontrata e prodhuesit me nënkontraktorë për furnizim me Gëlqere të Hidratizuar, Termoelektronën në Maqedoni nr. 03-74/16.05.2014, nr. 11-881/08.05.2015, nr. 03-22/08.05.2015.*
- *Vendimi i OSHP-se 404/16 datë 30-12-2016*
- *Njoftimi per anulimin e aktivitetit te prokurimit*
- *Njoftim per anulimin e dhenjes se kontrates*
- *Email nga z. Flamur Bekteshi (AK KEK) per refuzimin e kërkesës*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*